



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"  
VLORË  
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS  
Nr. 784/5 Prot.  
Datë 20.05.2020

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Vlorë më, 15. 05. 2020

**VENDIM**

**Nr. 30, datë 15. 05. 2020**

**MBI SHKRESËN NR. 617/ 1 PROT, DATË 08. 05. 2020**

Mbështetur në nenin 49, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 748, datë 11. 06. 2009 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë" i ndryshuar më VKM-në nr. 268/2017, si dhe shkresën nr.617/1 prot, datë 08. 05. 2020 të Rektorit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, në mbledhjen e datës 15. 05. 2020, Bordi i Administrimit vë re se:

me shkresën nr. 617/1 prot., datë 08.05.2020 "Për ndryshimin e vendimit të Bordit nr. 35, datë 11.07.2019", Rektori i UV-së kërkon nga Bordi i Administrimit ndryshimin e vendimit nr. 35/2019, duke e konsideruar vendimin si të paplotë, pasi në përcaktimin e vendimit përcaktohet pagesa për çdo orë 60 minutëshe për pedagogët e ftuar të kategorisë Profesor por jo për pedagogët e ftuar me gradën PhD. Rektori propozon që vendimit 35 të Bordit ti shtohet një pikë ku të përcaktohet pagesa për çdo orë 60 minutëshe për Lektorët më gradën PhD (Dr), në vlerën 880 lekë sipas pikës 7 shkronja ç) e VKM nr. 748, datë 11. 06. 2009 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, bazë ligjore të cilën Rektori e ka përdorur dhe në Vendimin 1343/8 datë 11.12.2019 për emërimin si personel akademik të ftuar, për PhD Rezart Hoxha. Në pikën 2 të vendimit të emërimit, Rektori ka përcaktuar dhe pagesën për pedagogun e ftuar në masën e dyfishit të parashikuar në pikën 7 shkronja ç) e VKM nr. 748, datë 11. 06. 2009, e ndryshuar.

Bordi pasi mori në shqyrtim propozimin vë re se, pika 7 e VKM nr.748 të ndryshuar, përcakton pagat për stafin akademik efektiv të të gjitha kategorive dhe jo për stafin akademik të ftuar, ndërsa për stafin akademik të ftuar pagesa përcaktohet në pikën 9 të VKM në fjalë, e cila përcakton se "Personeli akademik me kontratë, nga kategoria "Akademik" dhe nga kategoria "Profesor", në cilësinë e personaliteteve vendase ose të huaja, të paguhet me honorarë për ditë/orë pjesëmarrjeje në procesin e mësimdhënies në institucionet publike të arsimit të lartë. Përcaktimi i masës së honorarëve bëhet me vendim të rektoratit, pasi të jetë miratuar më parë në këshillin e administrimit. Masa e pagesës nuk duhet të jetë më e madhe se 5-fishi i pagesës për orët mbi normë, për kategorinë "Profesor". Mënyra dhe kriteret e këtyre pagesave të specifikohen sipas një udhëzimi të përbashkët të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë të Financave. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

*pagesave, të përballohen nga të ardhurat e veta të çdo institucioni të arsimit të lartë publik."*  
Duke marr parasysh këtë përcaktim rezulton se Vendimi nr. 35/2019 i Bordit të Administrimit në të cilin përcaktohet pagesa vetëm për kategorinë Profesor, është konform me pikën 9 të VKM e cila në asnjë moment nuk citon pagesën për staf akademik të ftuar që mban gradën PhD. Çështja nëse stafi akademik me gradën PhD (Dr) duhet të jetë i ftuar apo jo, është një çështje akademike që LAL nr. 80/2015 në nenin 62 e lë në vendimarrjen e njësive bazë sipas kriterëve të përcaktuara, po kështu dhe neni 47.2 të Statutit të UV-së, por ajo çka Bordi vë re është se mënyra e pagesës së tyre duhet të ndjekë të njëjtën procedurë si për pagesat e kategorive të tjera, pra me vendim paraprak të Bordit të Administrimit, pas vendimit apo propozimit të organeve apo autoriteteve drejtuese akademike (Rektoratit në bazë të nenit 26 të Statutit, apo Senatit akademik në bazë të neneve 19 dhe 45 të Statutit). Ndërkohë që në rastin në fjalë rezulton vendimi i emërimit së bashku me vlerën financiare të pagesës dhe i kërkohet Bordit të ndryshojë një vendim të mëparshëm (i cili është konform VKM nr. 748, datë 11. 06. 2009, e ndryshuar), për të rregulluar një fakt të kryer. Bordi për të zgjidhur situatën e pagesës së orëve të cilat janë zhvilluar në rastin në fjalë, mund ta konsiderojë si një propozim të ri ardhur nga Rektori për pagesën e stafit akademik të ftuar me gradën PhD. Nga sa më sipër BA:

**VENDOSI**

1. Të mos pranojë pjesën e propozimit të ardhur me shkresën nr. 617/1 prot., datë 08.05.2020 "Për ndryshimin e vendimit të Bordit nr. 35, datë 11.07.2019, në të cilën kërkohet ndryshimi i vendimit të Bordit të Administrimit nr. 35, datë 11. 07. 2019 "Për përcaktimin e kategorisë së pagave të personelit akademik të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë".
2. Të pranojë pjesën e propozimit të Rektorit në të cilin kërkohet që Personeli akademik i ftuar në rastin në fjalë të paguhet sipas Vendimit të Rektorit nr. 216, datë 11. 12.2019 "Për emërim personeli akademik i ftuar".
3. Ti kërkohet organeve kolegjiale akademike për t'u shprehur lidhur me vendimet e ardhshme dhe pagesën e tyre për personelin akademik të ftuar me gradën PhD apo Dr.
4. Bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi vendoset një kopje e shkresës nr. 617/1 prot, datë 08. 05. 2020.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë.
6. Ky vendim i përcillet për dijeni Rektoratit dhe Senatit akademik.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Dr. ERVIS MOÇKA**

